

Prishtinë: 16/10/2006
ERO/CPD_D_08_10_06

Nga: Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve

Për: Z. Fejzullah Krasniqi, adresa: Laxha e Universitetit, Prishtinë

Lënda: Përgjigje në Ankesën me Nr 17/10 2006 të datës 02.10.2006

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Përgjigjen e KEK-ut të datës 20.09.2006 në ankesën e konsumatorit nr. DPR – CO1 – 19 të datës 15.06.2006;
4. Ankesën e bërë nga konsumatori në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 02.10.2006 me numër regjistrimi 17/10 2006; dhe
5. Në përputhshmëri me Nenin 14.3 të Rregullit mbi procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 13.10.2006 ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe bazuar në faktet e paraqitura dhe në bazë të kompetencave të dhëna sipas Nenit 14.3 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve; Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve merr këtë:

VENDIM

Kërkesa e Konsumatorit Z. Fejzullah Krasniqi nga Prishtina **ËSHTË REFUZUAR** për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së të datës 02.10.2006 me nr. të ankesës 17/10 2006 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 20.09.2006, e cila përgjigje i është dhënë konsumatorit në lidhje me ankesën e tij me nr. DPR – CO1 – 19 të datës 15.06.2006.

Konsumatori në kërkesën e tij kërkon lirim nga pagesa e borxhit të ngarkuar me mbilimit në faturën e tij të periudhës së 2-të (muaji Shkurt) të vitit 2006 të datës 24.02.2006 në vlerë prej 192.79 € për energji, ngarkesën për fuqi 127.20 € dhe mbi limitin për fuqi në vlerë prej 38.56 €.

KEK-u në përgjigjen e tij ka shpjeguar se fatura të cilën e konteston konsumatori është për periudhën kur konsumatori nuk ka qenë i regjistruar si konsumator i rregullt, andaj fatura ka përfshirë periudhën 4.5 mujore të shpenzimit të konsumatorit nga momenti i vendosjes së njehsorit deri në momentin e leximit të njehsorit nga ekipet inspektuese të KEK-ut. KEK-u nuk ka ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj konsumatorit por vetëm e ka ngarkuar atë për energjinë e konsumuar dhe ka kërkuar nga konsumatori që të aplikoi për regjistrim të njehsorit të cilën gjë konsumatori e ka bërë me datën 29.03.2006.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRE-së, përgjigjen e KEK-u dhënë konsumatorit, dokumentet shtesë të ofruara nga konsumatori dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të aplikueshme në Kosovë, konstaton se përgjigja e KEK-ut dhënë Konsumatorit ishte në pajtim me legjislacionin në fuqi, andaj refuzon ankesën e konsumatorit si të pabazë.

DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE
ERO/CPD_D_08_10_06, dt. 16.10.2006

Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve
Azem Kastrati



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi Konsumatori mund të ankohet në Bordin e ZRRE-së në afat prej katërmëdhjetë (14) ditëve kalendarikë nga dita e marrjes së të njëjtit nga konsumatori apo nga dita e shpalljes në faqen elektronike të ZRRE-së, cila do që ndodhë më parë.

